

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“EM FLEET” SH.P.K.**

Sot, më date **05/03/2024**, UNE, i nënshkruari:

- **Evisa MEMA** lindur ne Fier, më 08/10/1983 , shtetase Shqiptare , mbajtese e leternjoflimit ID I36008067A , madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar

në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” kemi vendosur të themelojme një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar “**EM FLEET**” SH.P.K.. (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi.

Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj.

**Neni 1**

Emri i Shoqërisë është: “**EM FLEET**” SH.P.K

**Neni 2**

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Vlore, Bulevardi Ismail Qemali, Lagjia Lef Sallata, Objekt nr.33, Kulla 1, Kati 1

(1.1) Shoqëria ka te drejte qe ta ndryshoje adresen e selise se saj, dhe te shtoje adresa te reja te ushtrimit te aktivitetit.

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: **akfleet2024@gmail.com**

Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise, dhe jashte saj.

**Neni 3**

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat, per nje periudhe te pacaktuar kohore dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

## Objekti i veprimtarise se shoqerise

### Neni 4

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm:

- Agjenci operator turistik, detare, guide turistike, operator turistik detar
- Shoqeria mund te kryeje cfaredo lloj sherbimi qe paraqitet ne pajtueshmeri me objektin e saj dhe qe eshte lidhur me kete object.
- **Megjithate shoqeria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.**

### Neni 5

#### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **600.000** (gjashtëqind mijë ) Lekë, I ndare ne 1 (një) kuote me vlere 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë . Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Evisa MEMA**: Zotërues I 100% (njëqind përqind) te kuotave (1 Kuotë) me vlerë të përgjithshme prej **600'000** (gjashtëqind mijë) Leke që përbën **100 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para .

### Neni 6

#### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themeltar mund te behet vetem pasi Asamblea e ortakeve me shumice e ka dekretuar kcte dhe per me teper te gjithë ortaket jane te detyruar qe ta repektojne dhe te kontribuojne ne para ose ne natyre ne baze te vendimit te shumices se asamblese.



## **Neni 7**

### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen përmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërise
- b) shitblerjes;(me te drejten e parablerjes nga ana e ortakëve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të trasferueshme ndërmjet ortakëve, përsa nuk parashikohet ndryshe në statur. Pjesët e kapitakit themeltare janë ligjerisht të trasferueshme me rrugë trashgimnie.

## **Neni 8**

### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përrjashtimi nga e drejta e votës dhe te tjera modalitete per funksionimin e organit vendimmarres percaktohen ne statutin e shoqërise.

## **Neni 9**

### **Administrimi**

Administrator i perkohshem i shoqërise emerohet **Z. Lisander Zyberaj** lindur ne Vlore, me 03.09.1986, shtetas shqipetar , mbajtes i leternjoftimit ID I60903088P , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i zgjedhur per nje periudhe **5 vjet** pa te drejte rizgjedhje.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratorit jane te percaktuara qarte ne statutin e shoqërise.



## **Neni 10**

### **Viti financiar-ekspertët**

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjastimisht, viti i parë financiar fillon nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxierien e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

## **Neni 11**

### **Prishja-riorganizimi i shoqërisë**

Modalitetet për prishjen dhe riorganizimin e shoqërisë janë të përcaktuara në statutin e shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i Ndryshuar.

## **Neni 12**

Akti i Themelimit është hartuar në 4 kopje origjinale.

## **ORTAKU I SHOQËRISË**

**Evisa MEMA**

Evisa Mema  
